



Datë: 26.02.2026

Numër Protokolli: 1047/2026

A.nr.54/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani- anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.54/2026, të datës 19.01.2026, të parashtruar nga ankuesja M.B, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat F.P, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Këshilli Prokurorial i Kosovës, në çështjen juridike “*Ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, , si dhe të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 26.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.54/2026, e datës 19.01.2026, e parashtruar nga ankuesja, M.B.
- II. Mbetet në fuqi** Vendimi me shifër DPSKPK/Nr.11/2026, i datës 09.01.2026, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja M.B (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 19.01.2026, përmes postës dhe përfaqësuesit të autorizuar, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.54/2026 dhe numër protokolli 289/2026, kundër Vendimit me shifër DPSKPK/Nr.11/2026, të datës 09.01.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 21.01.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Këshilli Prokurorial i Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 29.01.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 289/2026 të datës 19.01.2026, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë, të datës 21.01.2026; Autorizimin; Akt emërimi i ankueses me numër protokolli DBNJ/DSKPK/531/2018, i datës 02.05.2018; Vendim me numër DPSKOK/Nr.11.2026, i datës 09.01.2026; Vendim me numër Nr.Prot.DPSKPK/77/2021, i datës 02.03.2021; Kërkesë për shfuqizimin e vendimit për pezullim dhe kthim në punë dhe detyrat e punës, me numër protokolli Nr.2070, e datës 24.11.2025; Plotësim kërkesë, me numër protokolli Nr.2116, e datës 01.12.2025; Vendim i lëshuar nga Gjykata Themelore-Prishtinë PKR.nr.223/24, e datës 22.05.2025; Përgjigje në ankesë e datës 29.01.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Aktgjykim i lëshuar nga Gjykata e Apelit PAKR.nr.387/2025, i datës 25.09.2025; Vendim me numër DPSKPK/Nr.11/2026, i datës 09.01.2026.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar**, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli DBNJ/DSKPK/531/2018, të datës 02.05.2016, mbante pozitën “Zyrtare e lartë Ekzekutive” në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa e njëjta për shkak se ndaj saj është iniciuar procedurë penale, përmes Vendimit Nr.prot.DPSKPK/77/2021 të datës 02.03.2021 ishte pezulluar me 50% të pagës nga marrëdhënia e punës nga U.D Drejtori i Përgjithshëm i SKPKS-së, deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Tutje, pas përfundimit të procedurës penale, sipas Aktgjykimin PKR.nr.223/24 të datës 22.05.2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ankuesja është shpallur fajtor për veprën penale “*Falsifikim i dokumenteve*”, dhe është dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 3.000 (tre mijë) euro, ndërsa pas ankesës ndaj këtij aktgjykimi, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm përmes Aktgjykimin PAKR.nr.387/25 të datës 25.09.2025, ka refuzuar ankesën duke e vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Mbështetur në Aktgjykimin PKR.nr.223/24 të datës 22.05.2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshilli Prokurorial të Kosovës, ka nxjerr vendim me numër protokolli Nr.11/2026, i datës 09.01.2026, përmes të cilit akt ankueses i përfundon marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, me arsyetimin se kryerja e veprës penale ka qenë me dashje ashtu që është përmbushur parakushti ligjor sipas dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër Vendimit me numër protokolli Nr.11/2026, të datës 09.01.2026, pretendon se vendimi i kontestuar është nxjerr si rezultat i shkeljeve të parimit të proporcionalitetit, mungesës së arsytimit të plotë dhe logjik, andaj propozon që ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta shfuqizojë Vendimin DPSKPK.nr.11/2026, të datës 09.01.2026, ta kthejnë në pozitën Zyrtare e Lartë Ekzekutive në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, me të gjitha të drejtat dhe detyrat duke kompensuar edhe të ardhurat 50% që nga data e suspendimit 02.03.2021 si dhe nga data e largimit nga puna 09.01.2026 e deri në ditën e kthimit në punë t'ia kompensoj të ardhurat personale 100% si dhe shtesat si dhe benificionet, të konstatojë se ndërprerja e marrëdhënies së punës është e kundërligjshme dhe jo proporcionale, ose ta kthejë çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje, pretendime këto të cilat i mbështet me arsytimin se në kohën kur ka ndodhur ngjarja ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili këtë çështje sipas dispozitave të nenit 90 paragrafi 2, nën paragrafi 4, dispozitë kjo e cila parashihte se Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër, ashtu që në rrethanat e rastit konkret kjo dispozitë nuk është përmbushë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses të parashtruar si në ankesë, analizoi legjislacionin e aplikueshëm për nëpunësit civil, në kohën e nxjerrjes së aktit të kontestuar, gjegjësisht Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht: Nenin 37 [Marrëdhënia e punës në shërbimin civil], paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj;* Nenin 73 [Përfundimi në rastet e caktuara nga ligji] paragrafin 1, ku përcaktohet se: *1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon për rastet e përcaktuara në ligj, kur: 1.1. nëpunësja/i vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; 1.2. nëpunësja/i humb shtetësinë, kur ajo kërkohet; 1.3. kur merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; 1.4. mbushet moshja për pensionim sipas Ligjit të Punës; 1.5. konstatohet paligjshmëria e aktit të emërimit; 1.6. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.*

Kolegji i Këshillit, po ashtu ju referua, Rregullores (QRK) Nr.29/2024 për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, konkretisht nenit 5 paragrafi 1, ku përcaktohet: *1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon në rastet si në vijim: 1.1. nëpunësi vdes, apo merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; 3 / 5 1.2. nëpunësi humb shtetësinë, kur ajo kërkohet; 1.3. kur merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; 1.4. arrihet moshja për pensionim sipas Ligjit përkatës për Punë; 1.5. konstatohet paligjshmëria e aktit të emërimit; 1.6. nëpunësi dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.*

Kolegji i Këshillit, bazuar në kuadrin përkatës ligjor, po ashtu ka analizuar aktin e goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimin numër protokolli Nr.11/2026, të datës 09.01.2026, me të cilin ankueses i është përfunduar marrëdhënia e punës, dhe si rrjedhojë ka gjetur se i njëjti është nxjerrë mbi bazën e dispozitave të nenit 73 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, për arsye se sipas Aktgjykimit PKR.nr.223/24 të datës 22.05.2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, është

dënuar për veprën penale *Falsifikim i dokumenteve* me dënim me gjobë në shumë prej 3.000 (tre mijë) euro, ndërsa ky aktgjykimi është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës përmes Aktgjykimitin PAKR.nr.387/25 me të datës 25.09.2025.

Kolegji i Këshillit, në referim të Aktgjykimit PKR.223/24 të datës 22.05.2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë i vërtetuar sipas Aktgjykimit PAKR.nr.38725 të datës 25.09.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, konstatohet fakti se ankuesja ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe është dënuar me gjobë në shumën prej 3.000 (tre mijë) euro rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, referuar aktgjykimeve të cekura më lartë, rezulton se ankuesja veprën penale përkatëse e ka kryer me dashje duke konstatuar tutje se vepra penale është kryer me dashje.

Andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se duke u nisur nga fakti se ankuesja është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, atëherë në mënyrë automatike aplikohen dispozitat e nenit 73 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 i Rregullores (QRK) Nr.29/2024 për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, sepse përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil në këto raste është i përcaktuar ligjërisht, kështu që në kuadër të kësaj, Kolegji sjell në vëmendje se akti i kundërshtuar me ankesë gjegjësisht Vendimi me numër protokolli Nr.11/2026, i datës 09.01.2026, i Këshillit Prokurorial të Kosovës, përveç që është në pajtim të plotë me dispozitat e cekura më lartë, është në pajtim të plotë dhe sipas kompetencave të autorizuara sipas nenit 14 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me të cilin paragrafi 3 i nenit 73 të ligjit bazik është ndryshuar, kështu që nga kompetenca e Njesisë për Menaxhimin e Birimeve Njerëzore për të konstatuar shkaku e përfundimin kjo kompetencë ka kaluar tek Zyrtari Kryesor Administrativ, kështu që përtej kësaj, akti i kundërshtuar me ankesën është në pajtim të plotë edhe me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2, nenin 5, nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse i njëjti është marr nga organi kompetent, është marr në frymën e ligjit dhe sipas obligimeve që dalin nga ligji material, përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ, dhe po ashtu përmban edhe arsyetim të saktë dhe konkretë, sikurse edhe dispozitivi i tij është në pajtim me legjislacionin, ngase sipas shkresave të lëndës, e përkitazi me këtë dispozitivi i vendimit është plotësisht në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që të gjitha pretendimet e palës ankuese janë të pabazuar sikurse edhe kërkesa e saj në petitumin të ankesës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se në dispozitat e aplikuara nga neni 99 [dispozitat kalimtare] të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nuk është trajtue çështja se a vlej në dispozitat e ligjit në fuqi në kohën kur është kryer vepra apo kur është iniciuar procedura penale sikurse ankuesja pretendon që vlej në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ashtu që në mbështetje të nenit 37 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, janë përmbushur parakushtet ligjore që marrëdhënia e punës në shërbimin civil për ankuesen të përfundojë, pasi që në kohën e nxjerrjes së Aktgjykimit PKR.223/24 të datës 22.05.2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë i vërtetuar sipas Aktgjykimit PAKR.nr.38725 të datës 25.09.2025 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, vlej në dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Theksuar si më sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.54 /2026, datë 26/02/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, Avokatit F. P;
- Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.